

Tiranë më, 27.01.2020

KOMUNIKIM

I SHOQATËS SHQIPTARE TË INXHINIERISË SIZMIKE (SSIS-AAEE)

Shoqata Shqiptare e Inxhinierisë Sizmike (SSIS-AAEE) duke analizuar situatën aktuale të pasojave të tërmeteve dhe nevojat për rindërtim dhe ndërtime cilësore shpreh qëndrimin dhe gatishmërinë, në përputhje me qëllimin e themelimit të saj, si më poshtë:

A. Analiza e dëmtimeve prej tërmetit të 26 Nëntorit të konstatuara gjatë inspektive të objekteve në Shqipëri

Dëmtimet në strukturat mbajtëse të godinave të banimit, social-kulturore dhe industriale në Durrës dhe Tiranë janë ndikuar nga disa faktorë, ndër të cilat rendisim:

- Legjislacioni që rregullon tërësinë e aktorëve të veprimtarisë së ndërtimit, si: projektues, oponentë, zbatues, supervizorë, kolaudatorë, investitorë, lejedhësit e ndërtimit, etj. nuk ndan përgjegjësitë;
- Ligjet në shumë raste krijojnë pamundësi për t'u zbatuar;
- Kushtet teknike në Shqipëri nuk janë rinovuar prej më shumë se 30 vjet. Shumë specialistë punojnë në kushte të vështira duke u përpjekur individualisht t'ju referohen standarteve të vëndeve të tjera apo Eurocodeve;
- Kushtet teknike të zbatimit nuk kanë shoqëruar ndryshimet e materialeve dhe teknologjisë së ndërtimit;
- Testimet e materialeve ndërtimore shpesh janë jo të mjaftueshme për t'u besuar. Laboratorët në disa raste punojnë me pajisje të paçertifikuara, të pakalibruara dhe në ndonjë rast interpretim i gabuar i rezultatit të provave;
- Studimet gjeologjike të truallit në disa raste nuk paraqesin parametrat e kërkuara në projektimin strukturor sipas emërtimeve në normat teknike;
- Skema konstruktive e objekteve mund të jetë e pranueshme, por jo më e mira;
- Ndryshimet në projekte prej arsyeve të ndryshme në shumë raste nuk janë shoqëruar nga inxhinierët e projektimit. Ka raste kur ndryshimet bëhen nga investitori, ndonjëherë nga inxhinieri që merr përsipër reduktimin e kostos apo lehtësimin e ndërtimit duke ndryshuar elementët konstruktivë (veçanërisht trarët);
- Janë vërejtur raste që gjatë zbatimit nuk realizohen detajet konstruktive të armimeve;
- Mos zbatimi i kushteve teknike të zbatimit gjatë betonimit apo mirëmbajtjes pas betonimit;
- Mosrealizimi i fugave sizmike apo realizimi i tyre pa plotësuar kriteret;
- Shtesat e kateve apo shtesat anësore në disa raste janë realizuar pa plotësuar kriteret e duhura të projektimit apo zbatimit;
- Degradimi i strukturave për shkak të mos mirëmbajtjes. Gjatë ekspertizave konstatohen objekte në lagështirë deri dhe bodrume që notonin në ujë. Për pasojë shumë elementë konstruktivë vërehen me armaturën e çelikut dhe betone të dëmtuar;
- Ndërhyrjet pa kriter në strukturat me muraturë mbajtëse, veçanërisht në katet e para.

Duke vlerësuar situatën e dëmtimeve të strukturave nga tërmetet kryesore dhe pas goditjet, vështirë se gjendet një rast, ku struktura është dëmtuar rëndë vetëm prej njërit faktor, p.sh:

- Mosvendosja e brezave në muraturat ndarëse është një element me influencë, por nuk është kjo kryesorja;

- Ka objekte të ndërtuar pa leje për të cilët sigurisht që kanë pritshmëri për dëmtime, por nuk kanë pësuar asnjë dëmtim prej këtyre tërmeteve;
- Ka objekte me shtesa kati që janë dëmtuar sikundër pritet, por ka midis tyre dhe të padëmtuar;
- Ka objekte të ndërtuar buzë detit apo në kënetë që janë dëmtuar, sikundër ka edhe të padëmtuar;
- Ka objekte të ndërtuara para viteve '90 që nuk janë dëmtuar ashtu si ka dhe të pas viteve '90 që janë dëmtuar.

Pra shkak i dëmtimeve të rënda janë kombinimi i disa faktorëve.

Parimisht përgjegjës për sigurinë dhe funksionalitetin e ndërtesës gjatë kohës së shfrytëzimit të saj janë specialistët e licencuar sipas fushës përkatëse (Sizmiolog, Gjeolog, Urbanist, Arkitekt, Strukturist, Mbikqyrës, Kolaudator, Investitor, Zbatues, Drejtues teknik dhe Drejtues ligjor). Përgjegjësi kanë dhe punonjësit e institucioneve të dhënies së lejeve të ndërtimit dhe të shfrytëzimit, punonjësit e institucioneve të proceseve të legalizimeve, etj. Këto përgjegjësi fillojnë që tek studimi urban, projekt ideja e deri në përdorim të objektit. Vënia në përdorim e ndërtesës implikon përgjegjësitë si të projektuesve, kompanive të zbatimit të punimeve ashtu edhe të organeve zyrtare të shtetit.

Në shumë raste ka shkelje të Kodit të Etikës. Disa prej tyre stimulohen apo dhe detyrohen nga këto amulli të tregut, të ligjshmërive dhe mos zbatimit korrekt të tyre.

Në shumicën e rasteve edhe profesionistët më të mirë e kanë të vështirë të përcaktojnë personin që ka shkaktuar dëmin, por e kanë të mundur të rendisin shumicën e shkaqeve që kanë çuar në pasojat e konstatuara.

Pra përgjegjësia është komplekse ndërkohë që interesi për zgjidhje është padyshim kolektiv.

Rekomandime:

Për gjetjen e shkaqeve të dëmtimeve, duhet të bazohemi në procedurë e metodologji, në ligjet e ndërtimit, në Kushtet Teknikë për projektimin, zbatimin, supervizimin dhe kolaudimin.

Duhet vetërregulluar një përfshirje e palëve të interesit duke eliminuar përplasjen e kompetencave ligjore.

Në shumicën e rasteve të objekteve të dëmtuara, kërkimi i fajit apo gabimit personal shkon drejt të pamundurës.

Por kjo në kushtet aktuale dhe në këto ligjshmëri që kemi nuk është e domosdoshme pasi nuk ndihmon për zgjidhjet e duhura në të ardhmen.

Nevojiten funksionimet reale të organizimeve profesionale në Shoqata dhe veçanërisht në Urdhrin e Inxhinierit që nëpërmjet Kodit të Etikës të ndalohen fenomenet negative dhe parandalohen gabimet njerëzore.

E rëndësishme dhe e nevojshme është të gjenden defektet ligjore për t'u përmirësuar si dhe të gjenden shkaqet e dëmeve për të nxjerrë mësim dhe konkluzione për të ardhmen.

B. Ligjshmëria e standarteve që duhen aplikuar

Për rindërtimin e objekteve të dëmtuara ku disa prej tyre kanë nevojë për përmirësim standarti por dhe të objekteve të reja që janë në proces nevojitet urgjentisht ligjshmëria e standarteve që duhen aplikuar. Standartet përbëhen nga një tërësi rregullash dhe nuk mund të aplikohen të pjesshme.

Dëmtimet nga tërmetet e fundit treguan se duhet të forcohen dhe përmirësohen kushtet teknike, harta sizmike oponencat e projektit, kontrollet, vlerësimet e ndërtimit dhe aktet e shfrytëzimit nga specialistët të aftë profesionalisht.

Në situatën e sotme çdo strukturë, jo vetëm ato të dëmtuarat, duhet të vlerësohet nga pikëpamja e kapacitetit të saj, me qëllim për të ditur sigurinë e saj në tërmetet e ardhshme.

Në vendin tonë, me risk të lartë sizmik, për të reduktuar ndjeshëm pasojat fatale, këmbëngulim me të gjithë forcën e arsyes profesionale që:

Në të gjitha studimet mbi planifikimin e territorit në Republikën e Shqipërisë të reflektohen plotësisht, studimet sizmike, studimet gjeologo-inxhinierike, kushtet teknike të projektimit antisizmik të përmirësuar, për të cilat në mënyrë të përsëritur kemi kërkuar të përditësohen për të reflektuar arritjet e praktikës botërore në mbrojtjen antisizmike të strukturave si dhe konkluzionet prej tërmeteve të fundit.

Mbështetur në praktikën më të përparuar botërore të vendeve me risk të lartë sizmik sugjerojmë që të hartohet sa më shpejt kadri i nevojshëm ligjor që adreson përgjegjësinë e drejtimit të grupit të projektimit tek inxhinieri i strukturës për godinat ku rezistenca ndaj tërmetit është e një rëndësie të vecantë sa i takon pasojave të shoqëruara me shkatërrimin e tyre (Klasa III dhe Klasa IV sipas prEN 1998-1).

Në studimet urbane dhe arkitektonike duhen reflektuar përpjekjet dhe rekomandimet e inxhinierëve të projektimit të strukturave që në zona me risk të lartë sizmik të realizohen objekte me volumetri të rregullt për të patur më shumë siguri në mbrojtjen e tyre nga tërmetet e pritshme e të pashmangshme. Në Ligjin Nr.10/119, datë

23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit" nuk ka asnjë paragraf apo nen që të detyrojë volumetrinë e rregullt si hap thelbësor e shpesh përcaktues në mbrojtjen e objekteve nga tërmeti. Kodet e projektimit antisizmik rekomandojnë forma të rregullta në plan dhe lartësi të strukturave. Në raste të veçanta, nëse objektet me forma të parregullta janë të pashmangshme, projektimi i strukturës të bëhet nga inxhinier strukture me liçencë të posaçme.

Rekomandime:

- Duhet të forcohen dhe përmirësohen kushtet teknike, harta sizmike oponencat e projektit, kontrollet, vlerësimet e ndërtimit dhe aktet e shfrytëzimit nga specialistë të aftë profesionalisht.
- Të specifikohet një pikë e veçantë në liçencen e projektimit për strukturat me volumetri të parregullta.

C. Situata e vlerësimeve dhe veprimet pas fazave të inspektimeve

Qytetarët që drejtohen për ndihmë dhe zgjidhje profesionale nuk po e shohin dhe nuk po ndjejnë përfshirjen e specialistëve që do t'ju jepte sigurinë e nevojshme dhe të mjaftueshme. Në këtë pasiguri janë duke bërë plane për zgjidhje individuale shpesh me shumë energji dhe pa efektivitet teknik, personal apo shoqëror.

Një pjesë jo e vogël e aktorëve të ndërtimit (Investitorë, Zbatues, Drejtues teknik, Drejtues ligjor, Mbikqyrës, Kolaudatorë, Strukturistë, Arkitektë, Urbanistë, Gjeologë, Sizmologë, etj.), po veprojnë në kushte paniku dhe për rrjedhojë në dëm të cilësisë së objekteve.

Nga buron paniku i tyre?

Së pari, prej dëmtimeve të objekteve që kanë ndërtuar, projektuar, supervizuar, kolauduar apo thjesht kanë qënë drejtues teknik (real apo formal), kanë dhënë leje ndërtimi apo shfrytëzimi jashtë ligjeve, kanë legalizuar objekte me problematika teknike apo ligjore.

Së dyti, janë të frikësuar nga mënyra se si po kërkohen dhe përzgjidhen fajtorët e etiketuar si shkaktarët e dëmeve.

Së treti, pasiguria që krijon procedura dhe menaxhimi joprofesional për riparimin dhe përforcimin e objekteve të dëmtuara.

Arsye të tjera që sipas specifikave mund të jenë të pa adresuara për zgjidhje.

Rekomandime:

- Nevojitet relaksimi i tregut që aktorët pozitivë me mundësitë dhe aftësitë e mjaftueshme të mirë organizohen për të kryer me saktësi procesin e rindërtimit dhe më tej për ndërtimet e reja në të ardhmen;
- Të ngrihen strukturat profesionale që të flasin, të shkruajnë dhe të përgatitin Raportin Teknik për shkaqet e dëmeve dhe metodologjitë e rregullimit të tyre.

Nuk mund të kryhen procedurat dhe zgjidhjet profesionale nëpërmjet sugjerimeve, mendimeve dhe komenteve të rrjeteve sociale si: facebook, por nëpërmjet institucioneve. Këto rrjete ndihmojnë thjesht grumbullimin dhe shpërndarjen e shpejtë të informacioneve.

Të gjithë mund të ndihmojnë apo dhe pengojnë, por organizimet e nevojshme shtetërore dhe profesionale kanë për detyrë të gjejnë dhe japin zgjidhjet e duhura.

Dëmtimet nga tërmetet janë të pritshme në një nivel të caktuar, por mund të jenë dhe më të rënda nëse nuk merren masat e duhura veçanërisht pas tërmeteve të fundit.

Me siguri po vjen dita që do të vepohet si duhet, por sa më vonë aq më vështirë për të rikuperuar të shkuarën.

Për më shumë informacion në lidhje me Shoqatën, ju lutem vizitoni në: www@ssis.org.al.

Për Shoqatën Shqiptare të Inxhinierisë Sizmike

Dr. Inxh. Agim SERANAJ,
Kryetar i SSIS-AAEE

